



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.403/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjore Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Vushtrri, Egzon Dallku rr “Shefki Dallku”, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.A.nr.403/2017, i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, Egzon Dallku nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Vushtrri, e paraqitur me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Egzon Dallku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilën pretendon se në fshatin Pestovë, në vendvotimet nr.2722B/01R, në rrugën “Ali Kelmendi” në Vushtrri, në venvotimin nr. 2702B/01R dhe në rrugën “Lutfi Maliqi” në Vushtrri në vendvotimin 2701B/07R ka pa rregullsi dhe PZAP-it i ka kërkuar rinumërimin e votave.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë përkitazi me pa rregullsit e votave fshatin Pestovë, në vendvotimet nr.2722B/01R, në rrugën “Ali Kelmendi” në Vushtrri, në venvotimin nr. 2702B/01R dhe në rrugën “Lutfi Maliqi” në Vushtrri në vendvotimin 2701B/07R, për shkak të pa rregullsive, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Egzon Dallku, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e

drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.403/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*